



## **Mbrojtja e të drejtave të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian**



**Dhurata Prokshi  
Janar 2020**

## Contents

Hyrje.....	2
Edukimi .....	2
E drejta e shkollimit parauniversitar .....	2
Arsimi i lartë.....	6
PUNËSIMI .....	8
E drejta e punës .....	8
Masat Afirmative të Punësimit .....	8
BANIMI .....	10
MIRËQENIA SOCIALE.....	12
Martesat ilegale (të hershme) nën moshën 18 vjecare .....	12
Kërkim lëmosha .....	13
Përfundim .....	15

## Hyrje

Republika e Kosovës, në lidhje me të drejtat e njeriut ka kornizë ligjore të zhvilluar dhe të kompletuar, e cila gjithashtu është në harmoni me kornizën ligjore të BE-së.

Përfshirja dhe referimi i konventave ndërkombëtare dhe evropiane në kornizën legislative dhe kushtetuese të Kosovës ka bërë që në aspektin legjislativ, Kosova të jetë në një nivel me shtetet perëndimore sa i përket të drejtave që u garanton qytetarëve të saj të të gjitha komuniteteve.

Është kushtetueshmërisht e projektuar që Kosova të jetë shtet i cili jo vetëm vetëm respekton, por edhe nxit ekzistencën e një shteti shumetnik ku të gjitha grupet përbërëse kanë lirinë dhe të drejtat për të formësuar identitetin e tyre kulturor dhe etnik, si dhe për të qeverisur me punët që ndikojnë në komunitetet e tyre respektiv. Për ndërtimin e një shteti të tillë, që njeh dhe respekton të drejtat e çdo entiteti është dhënë kontribut i madh nga ana e arkitektëve të strukturave qeverisëse në Kosovë në mënyrë që të sigurohet përfaqësim i barabartë dhe/ose proporcional politik dhe institucional të grupeve pakicë të Kosovës.

Analiza e mbrojtjes së të drejtave të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian është bërë në perspektivën e gjendjes faktike nga hulumtime të ndryshme dhe analizës së kornizës ligjore ekzistuese për fushat e arsimit, punësimit, banimit dhe mirëqenies sociale. Gjithashtu, janë identifikuar dispozitat ndëshkuese në rast të shkeljes së të drejtave dhe mekanizmat dhe institucionet përgjegjëse për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe komuniteteve pakicë në Kosovë.

## Edukimi

### E drejta e shkollimit parauniversitar

Shkollimi parauniversitar është e drejtë themelore për secilin qytetar të Kosovës e cila përkrahet dhe nga konventa të ndryshme ndërkombëtare. Për të qenë në përputhje me këto konventa, Qeveria e Kosovës ka zhvilluar politika për të garantuar kjo e drejtë. Mirëpo, fëmijët rom, ashkali dhe egjiptianë të Kosovës vazhdojnë të përballen me sfida në qasjen në arsim cilësor dhe janë të prekur më shumë nga mosregjistrimi, braktisja, analfabetizmi në shkallë të lartë, si dhe arritje të ulëta arsimore.<sup>1</sup>

Të dhënat nga një studim i Agjencisë së Statistikave të Kosovës në lidhje me nivelin arsimor të fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian janë se vijueshmëria e arsimit në të moshës 36-59 muajsh që vijojnë ndonjë program të arsimit parashkollor është 16.1%. Përgatitja për shkollë bazuar në përqindje të fëmijëve në klasën e parë të shkollës fillore që kanë vijuar arsimin parafillor gjatë vitit shkollor paraprak është 53.9

---

<sup>1</sup>S.Shahini. (KOSINT2020). "Vështirësitë e nxënësve të komuniteteve rom, ashkali, dhe egjiptian në shkollë" (2019). [http://kosint2020.net/site/assets/files/1466/raport\\_tematik\\_mbi\\_veshtiresite\\_qe\\_hasin\\_nxenesit\\_e\\_komuniteteve\\_rom\\_ashkali\\_dhe\\_egjiptian\\_ne\\_shkollim-1.pdf](http://kosint2020.net/site/assets/files/1466/raport_tematik_mbi_veshtiresite_qe_hasin_nxenesit_e_komuniteteve_rom_ashkali_dhe_egjiptian_ne_shkollim-1.pdf)

% Shkalla neto e regjistrimit në arsimin fillor është 68.1%. Përqindja e fëmijëve të moshës së shkollës fillore që aktualisht vijnë në arsimin fillor ose të mesëm është 85.3%.<sup>2</sup>

### **Mos regjistrimi në shkollë fillore:**

Lidhur me regjistrimin e fëmijëve në klasë të parë janë analizuar raste dhe raporte të ndryshme që tregojnë për mos-regjistrimin e fëmijëve në klasën e parë apo regjistrimin me vonesë. Organizata të ndryshme të shoqërisë civile, zhvillojnë kampanja informative të vazhdueshme për prindërit e fëmijëve në lagje të caktuara mbi rëndësinë e regjistrimit, afatet dhe dokumentet e nevojshme, mirëpo fenomeni i mos regjistrimit akoma ekziston. Kur bëhet fjalë për regjistrimin në kohë të fëmijëve në shkolla dhe detyrimin ligjor të prindërit që ta dërgojë fëmijën në shkollë, duhet të theksohet që përveç mungesës së vetëdijes së prindit për shkollimin dhe arsyetimin e tyre në mënyra të ndryshme për mos përmbushjen e detyrave si prindër, kemi edhe heshtjen e institucioneve sikurse që janë: Shkolla dhe Qendra për Punë Sociale të cilat nuk reagojnë në raport me shkelje të tilla.

### **Braktisja e shkollimit:**

Përveq fenomenit të mosregjistrimit, informatat dhe raporte të ndryshme tregojnë që braktisja e shkollimit vazhdon të jetë fenomen shqetësues për arsimin në Kosovë dhe me theks të veçantë prek nxënësata nga radhët e komuniteteve. Përkundër faktit që MASHT ka paraparë sistem për parandalimin e hershëm të braktisjes së shkollimit dhe ekupe brenda shkollës për të punuar në parandalim të braktisjes ato siç vërehet nga hulumtimi në teren nuk janë efikase. Një gjë të tillë e pohojnë edhe gjetjet e raportet të fokusuar në efektivitetin e EPRBM-ve të fëmijët rom, ashkali dhe egjiptian, thuhet se rastet e braktisjes së mësimin janë të identifikuar më së shumti nga pjestarë të shoqërisë civile, dhe se EPRBM nuk janë funksionale për të përmbushur përgjegjësitë e tyre.<sup>3</sup>

### **Regjistrimi dhe bursat në shkolla të mesme:**

Ngritjen e vijueshmërisë në shkollimin të mesëm nga nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, e ka ndihmuar në mënyrë të dukshme shoqëria civile në Kosovë, më saktësisht Programi i Bursave në bashkëpunim me MASHT dhe organizatat si KFOS, VoRAE, HEKS, dhe REF.<sup>4</sup> Bursat si masë afirmative që lehtësojnë dhe motivojnë nxënësit në vijimin e shkollimit të mesëm kanë arritur shtrirje në gjithë Kosovën tek nxënësit nga radhët e këtyre komuniteteve të cilët kanë ndjekur shkollimin fillor dhe përgatiten për të vazhduar shkollimin e mesëm. Ofrimi i bursave të tilla, në aspekt ekonomik e lehtëson barrën financiare të familjeve të këtyre komuniteteve në raport me shkollimin e fëmijëve. Regjistrimi i nxënësave të komuniteteve në shkolla të mesme përcjellat me sfida me rastin e përzgjedhjes dhe përcaktimit të drejtimit të dëshiruar, dhe parakusht për suksesin e tij është mos braktisja e shkollës së

---

<sup>2</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës, Komunitetet Rom dhe ashkali në Republikën e Kosovës, Anketa e Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë 2013-2014

<sup>3</sup> M. Telaku. (KOSINT2020) "Raport vlerësues mbi efektivitetin e EPRBM-ve" (2019).

[http://kosint2020.net/site/assets/files/1464/raport\\_i\\_fokusuar\\_ne\\_efektivitetin\\_e\\_eprbm-ve\\_te\\_femijet\\_rome\\_ashkali\\_dhe\\_egjiptian-1.pdf](http://kosint2020.net/site/assets/files/1464/raport_i_fokusuar_ne_efektivitetin_e_eprbm-ve_te_femijet_rome_ashkali_dhe_egjiptian-1.pdf)

<sup>4</sup> KOSINT. "Programet e bursave për studentët romë, ashkali dhe egjiptianë të arsimit të mesëm të lartë në Kosovë" (2019). [kosint2020.net/site/assets/files/1420/programet\\_e\\_bursave\\_per\\_nxenesit\\_rom\\_ashkali\\_dhe\\_egjiptian\\_ne\\_arsimin\\_e\\_mesem\\_te\\_larte\\_ne\\_kosove.pdf](http://kosint2020.net/site/assets/files/1420/programet_e_bursave_per_nxenesit_rom_ashkali_dhe_egjiptian_ne_arsimin_e_mesem_te_larte_ne_kosove.pdf)

mesme dhe ngritja e suksesit që do të ju ndihmonte këtyre fëmijëve pikënisje dhe pozicionim të ngjashëm me bashkëmoshatarët e tyre.

Nga raporte të ndryshme është vërjetur që ka disa grupe të faktorëve që e vështirësojnë përfshirjen e nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin parauniversitar dhe atë univeristar, duke përfshirë regjistrimin me numër të vogël në shkollë dhe braktisje të shkollimit të vazhdueshëm. Faktorët ekonomik, cështjet shëndetësore cështje sociale, problemet në të mësuar, mungesa në orë mësimi, diskriminimi, gjuha dhe qasja në shkollë.<sup>5</sup>

### Korniza ligjore:

Kushtetuta e Republikës së Kosovës është dokumenti më i rëndësishëm në Kosovë, e cila i përcakton shumë të drejta, liri e obligime që secili qytetar dhe institucion duhet të ju përmbahet. Sa i përket shkollimit parauniversitar, neni 47 citon të drejtën për arsim, ku secili person gëzon të drejtën e shkollimit themelor pa pagesë. Shkollimi i detyrueshëm rregullohet me ligj dhe financohet nga fondet publike. institucionet publike sigurojnë për secilin person mundësi të barabarta për t'u arsimuar, sipas aftësive dhe nevojave të veçanta të tij/saj.<sup>6</sup>

Gjithashtu, për të obliguar dhe rregulluar shkollimin parauniversitar, MASHT, ka përpiluar disa akte ligjore. Ligji nr. 04/L-032 për arsimin parauniversitar në Nenin 3 përshkruan parimet e përgjithshme të arsimit parauniversitar, se si asnjë personi nuk guxon t'i mohohet e drejta për arsimim. Gjithashtu, Neni 4 specifikon se në arsim duhet të mbrohen grupet e cenueshme nga fjalët, veprimet, ndëshkimet fizike që mund të hasin nxënësit.<sup>7</sup>

Ligji nr. 06/L-084 për mbrojtjen e fëmijës, në lidhje me përmbushjen e të drejtës së arsimit parauniversitar, neni 37 e shpjegon detajisht se si ndalohet privimi i fëmijës nga e drejta për edukim dhe arsimim. Ministria përkatëse për arsim duhet të sigurojë qasje gjithëpërfshirëse dhe frekuentim të arsimitit falas e cilësor, në bazë të mundësive të barabarta dhe pa diskriminim, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar në gjitha nivelet e arsimit para universitar. Gjithashtu në këtë nen përshkruhen që fëmija mbrohet nga të gjitha format e dhunës fizike dhe mendore nga të gjithë. Për më tepër, Neni 8 përshkruan që fëmijët nuk duhet të diskriminohen në asnjë formë, dhe se cdo fëmijë ka të drejtë në të njëjtat të drejta të njohura me legjislacionin në fuqi dhe Konventën, t'i garantohen ato pa asnjë lloj dallimi.<sup>8</sup>

Ligji 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në nenin 8 lidhur me arsimimin përshkruan që të gjithë personat që iu përkasin komuniteteve kanë të drejtë të marrin shkollim publik në të gjitha nivelet, në njërin nga gjuhët zyrtare të Kosovës që ata e

---

<sup>5</sup>S.Shahini. (KOSINT2020). "Vështirësitë e nxënësve të komuniteteve rom, ashkali, dhe egjiptian në shkollë" (2019). [http://kosint2020.net/site/assets/files/1466/raport\\_tematik\\_mbi\\_veshtiresite\\_qe\\_hasin\\_nxenesit\\_e\\_komuniteteve\\_rom\\_ashkali\\_dhe\\_egjiptian\\_ne\\_shkollim-1.pdf](http://kosint2020.net/site/assets/files/1466/raport_tematik_mbi_veshtiresite_qe_hasin_nxenesit_e_komuniteteve_rom_ashkali_dhe_egjiptian_ne_shkollim-1.pdf)

<sup>6</sup>Kushtetuta e Republikës së Kosovës <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>

<sup>7</sup>Ligji nr. 04L-032 për arsimin parauniversitar të Republikës së Kosovës <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2770>

<sup>8</sup>Ligji nr. 06/L-084 për mbrojtjen e fëmijës <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=20844>

zgjedhin. Personat që iu përkasin komuniteteve kanë të drejtë në shkollim publik parashkollor, fillor dhe të mesëm në gjuhën e tyre edhe nëse ajo nuk është gjuhë zyrtare.<sup>9</sup>

Për t'a adresuar problemin e braktisjes së shkollimit dhe mosregjistrimit në shkollë, MASHT ka hartuar Udhëzimin Administrativ nr.08/2018 për themelimin dhe fuqizimin e Ekipeve për Parandalim dhe Reagim kundër Braktisjes dhe Mosregjistrimit të nxënësve në arsimin parauniversitar (EPRBM) të nxënësve në Arsimin. Këto ekipe janë themeluar nëpër shkolla fillore, të mesme të ulëta dhe në ato të mesme të larta, si dhe në nivel nacional në MASHT.<sup>10</sup>

Gjithashtu, MASHT ka hartuar Udhëzimin Administrativ nr. 19/2018 mbi themelimin dhe funksionalizimin e Qendrave Mësimore, që përcakton kriteret dhe procedurat e themelimit dhe funksionimit të qendrave mësimore që ofrojnë mbështetje plotësuese dhe aktivitete të tjera edukativo-arsimore për të gjithë fëmijët që kanë nevojë shtesë.<sup>11</sup>

Plani Strategjik për Arsim në Kosovë 2017-2021 përshkruan si sfidë që është përfshirja dhe pjesëmarrja e ulët në arsim e fëmijëve nga grupet e marginalizuara në veçanti pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Përfshirja e fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian në edukimin parashkollor dhe të mesëm të lartë është tejet e ulët, ndërkohë që shkalla e regjistrimit bruto në arsimin e detyrueshëm (klasat 1-9) është rreth 85% që, përsëri, është dukshëm nën mesataren e vendit. Sipas PSAK, rezultati i pritshëm 1.4 përfshirja e fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin fillor është të rritet për 10%, ndërsa në arsimin e mesëm të ulët dhe të lartë për 20%.<sup>12</sup>

Strategjia për përfshirjen e komuniteteve Rom dhe Ashkali 2017-2021 përshkruan gjendjen e arsimit të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në të gjitha nivelet e arsimit. Arsimi është fusha 1, ku ka dhe rezultate specifike të cilat duhet të arrihen përmes aktiviteteve të caktuara deri në vitin 2021 duke përfshi përmirësimin e pjesëmarrjes në arsim, përmirësimin e performancës së nxënësve dhe studentëve, dhe të ndërgjegjësohen palët e interesit për të ndihmuar arsimimin e pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali.<sup>13</sup>

### Mekanizmat/institucionet përgjegjëse:

Mekanizmat dhe insitucionet kryesore për të siguruar qasjen në arsimin parauniversitar janë: Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Teknologjise, Drejtoritë Komunale të Arsimit, EPRBM, Drejtoritë e shkollave, Avokati i Popullit, Qendrat për Punë Sociale, dhe përgjegjë kryesor janë Prindërit e fëmijëve. Të gjitha këto përkrahen nga ligjet, si më poshtë:

<sup>9</sup> Ligji 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre <https://gzk.rks.gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2531>

<sup>10</sup> Udhëzimi Administrativ (MASHT) nr.08/2018 për themelimin dhe fuqizimin e EPRBM të nxënësve në Arsimin Parauniversitar <https://masht.rks.gov.net/uploads/2018/06/8-ua-masht-nr-08-2018-per-themelimin-dhe-fuqizimin-e-ekipeve-parandalim-dhe-kbmnapu.pdf>

<sup>11</sup> Udhëzimin Administrativ (MASHT) nr. 19/2018 mbi themelimin dhe funksionalizimin e Qendrave Mësimore <https://masht.rks.gov.net/uploads/2018/12/ua-nr-19-masht-per-themelimin-dhe-funksionimin-e-qendrave-mesimore-x.pdf>

<sup>12</sup> Plani Strategjik për Arsim në Kosovë 2017-2021 [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/PLANI\\_STRATEGJIK\\_I\\_ARSIMIT\\_NE\\_KOSOVE.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/PLANI_STRATEGJIK_I_ARSIMIT_NE_KOSOVE.pdf)

<sup>13</sup> Strategjia për përfshirjen e komuniteteve Rom dhe Ashkali 2017-2021 <https://www.rcc.int/romaintegration2020/download/docs/ALB-STRATEGJIA%20P%C3%8BR%20P%C3%8BRFSHIRJEN%20E%20KOMUNITETEVE%20ROM%20DHE%20ASHKALI%20N%C3%8B%20SHOQ%20C3%8B%20KOSOVARE%202017-2021.pdf/a8e1293c6955519e788ae28d84fb11a4.pdf>

Ligji nr. 04/L-032 për arsimin parauniversitar neni 3, përshkruan që arsimi parauniversitar është përgjegjësi e përbashkët e prindërve, institucioneve arsimore dhe aftësuese, komunave dhe qeverisë, sipas funksioneve dhe detyrave përkatëse të përcaktuara në këtë ligj. Gjithashtu, neni 4 specifikon se përgjegjës për mbrojtje të fëmijëve nga dhuna janë të gjithë personat e punësuar në institucionet arsimore. Neni 15 përshkruan se vijueshmëria në shkollë është e detyruar, dhe për këtë përgjegjës kryesor janë prindërit e fëmijëve.<sup>14</sup>

Ligji nr. 06/L-084 për mbrojtjen e fëmijës neni 37 e thekson, që është detyrë e prindërve apo kujdestarëve të kujdesen për vijim e shkollës së fëmijës, përderisa MASHT dhe institucionet lokale kanë detyrë të sigurojnë qasje të duhur dhe zhvillim të planprogramit sa më të mirë për të gjithë fëmijët. Neni 8 thekson që është obligim i të gjitha institucioneve, ofruesve të shërbimeve, profesionistëve për mbrojtjen e fëmijës, që duhet të marrin të gjitha masat e duhura, me qëllim që fëmija të jetë i mbrojtur nga të gjitha format e diskriminimit<sup>15</sup>

### Dispozitat ndëshkimore:

Sipas Kodit Penal nr. 06/L-074, neni 246 pengimi dhe mosekzekutimi i masave për mbrojtjen e fëmijëve, shpjegon se kushdo që nuk e zbaton apo e pengon ekzekutimin e masave edukative dhe masave të tjera të përcaktuara nga gjykata ose nga një organ tjetër kompetent përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit. Gjithashtu, kushdo që si person përgjegjës në punë, në organe apo në ente për mbrojtjen, arsimimin ose aftësimin profesional të fëmijëve, ushtron haptazi detyrat e tij në mënyrë të papërgjegjshme dhe me këtë rrezikon apo dëmton rëndë shëndetin apo zhvillimin e fëmijës, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.<sup>16</sup>

Ligji nr. 04/L-032 për arsimin parauniversitar në nenin 15 përshkruan nëse nxënësi pa ndonjë arsye nuk regjistrohet, nuk vijon shkollimin ose e ndërpre në shkollimin e detyruar, prindërit e tij dënohen për kundërvajtje nëse mungesa është rezultat i veprimit të paramenduar ose i neglizhencës së prindërve. Në raste të tilla, komuna e njofton Ministrinë me shkrim.<sup>17</sup>

### Arsimi i lartë

Arsimi i lartë i pjestarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian ka arritur të shënoj përmirësime në ngritjen e numrit të studentëve të cilët kanë regjistruar studimet dhe mbaruar ato, studentëve që janë ende në proces të studimeve. Një kontribut të jashtëzakonshëm në këtë drejtim vazhdojnë ta japin organizatat jo qeveritare ku veçohet puna që organizata Roma Versitas bën me studentët duke ju ofruar bursa për studime, programe të ndryshme të mentorimit dhe praktikës me qëllim të përgaditjes për treg të punës.

Udhëzimi Administrativ Nr.09/2016 i miratuar nga MASHT për Zbatimin e Masave Afirmative dhe Vendeve për Regjistrimin e Studentëve të Komuniteteve Joshumicë në Institucionet Publike të Arsimit të

<sup>14</sup>Ligji nr. 04L-032 për arsimin parauniversitar të Republikës së Kosovës <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2770>

<sup>15</sup>Ligji nr. 06/L-084 për mbrojtjen e fëmijës <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=20844>

<sup>16</sup>Kodi Penal nr. 06/L-074 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413>

<sup>17</sup>Ligji nr. 04L-032 për arsimin parauniversitar të Republikës së Kosovës <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2770>

Lartë, përcakton kuotën e 12% vendeve të rezervuara në të gjitha universitetet publike të Kosovës për pjestarët e komuniteteve duke prezantuar formën e vetë-identifikimit etnik përmes verifikimit nga zyrat komunale për komunitete dhe kthim.<sup>18</sup>

Vlen të theksohet se mungesa e harmonizimit të dokumentit të vetë-identifikimit etnik përmes verifikimit nga ZKKK ka reflektuar me paknaqësi nga pjestarët e komuniteteve, me dyshimin e kuota e rezervuar për pjestarët e komuniteteve është keqpërdorur, edhe pse nuk ka të dhëna zyrtare mbi një fenomen të tillë.

Prandaj, lëshimi i dokumentit të vetëdeklarimit të etnicitetit, do të duhej të përmbaj kritere me rastin e vetëdeklarimit marrë parasysh që mund të ndodhë vetëm për hirë të gëzimit të një të drejte të mundësuar si masë afirmative. Të përcaktohet nga kush monitorohet, nëse është një veprim i tillë pa bazë, kush mban përgjegjësi ligjore. Ky dokument për studentët është më mirë të rregullohet të lëshohet nga Agjencioni i Statistikave i Kosovës.

### Korniza ligjore:

Sa i përket arsimit të lartë janë disa akte ligjore që e përshkruajnë dhe rregullojnë këtë të drejtë.

Qëllimi i Ligjit 04/L-037 për Arsimin e Lartë, përshkruhet në nenin 1 i cili është krijimi i bazës ligjore për rregullimin, funksionimin, financimin, dhe sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë. Në nenin 2 janë të përshkruara parimet me të cilat rregullohet arsimi i lartë, dhe ku duhet të ofrohen mundësi të barabarta për të gjithë studentët dhe personelin. Neni 5 shpjegon që në arsimin e lartë që ofrohet nga bartësit e licencuar të arsimit të lartë në Kosovë do të kenë qasje të gjithë personat brenda apo jashtë territorit të Kosovës, pa asnjë lloj diskriminimi dhe nuk ka kufizim moshe për t'u regjistruar apo për të fituar kualifikim të arsimit të lartë. Neni 29, specifikon që secili kandidat që e kalon testin e maturës, gëzon të drejtën për të vazhduar studimet në institucionet e arsimit të lartë.<sup>19</sup>

### Mekanizmat/institucionet përgjegjëse:

Institucioni kryesor që rregullon qasjen në arsimin e lartë është Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Teknologjisë. Për të ndihmuar qasjen në arsim të lartë të studentëve të komunave të ndryshme, gjithashtu Drejtoritë Komunale të Arsimit kanë rol të rëndësishëm në rastë kur ofrojnë bursa studimi. Drejtoritë dhe stafi i universiteteve publike dhe private janë gjithashtu të rëndësishme në ofrimin më të mirë të qasjes në arsim të lartë.

### Dispozitat ndëshkimore:

Arsimi i lartë, nuk është i detyrueshëm në Kosovë, andaj nuk ka dispozita ndëshkimore specifike. Megjithatë, studentëve që i cenohet e drejta për qasje të barabartë në regjistrim, vijim, dhe përfundim të studimeve mund të paraqes në gjyq institucion universitar që ka shkelë të drejtat e tyre. Gjithashtu,

---

<sup>18</sup>Udhëzimi Administrativ (MASHT) Nr.09/2016 <https://masht.rks-gov.net/uploads/2016/06/ua-masht-09-2016-aplikimi-i-masave-afirmative-dhe-vendeve-te-rez-al.pdf>

<sup>19</sup>Ligji 04/L-037 për Arsimin e Lartë <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2761>



sa i përket falsifikimit të dokumentave të ndryshëm, sipas Kodit Penal nr. 06/L-074 neni 390 dënohet me gjobë dhe burgim prej prej 1 deri 8 vjet.<sup>20</sup>

## PUNËSIMI

### E drejta e punës

Kuota për punësimin e komuniteteve si masë për sigurimin e përfshirjes së barabartë të të gjitha komuniteteve që jetojnë në Kosovë, ka zbatim shumë të vogël. Marrë parasysh që Ligji për Shërbyes Civil që përcakton kuotën prej 10% për komunitete, kur bëhet fjalë për punësimin e pjestarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian nuk ka gjetur zbatim.

Gjatë vitit 2018, nga 56 institucione të nivelit qendrorë që numëronin 30,635 të punësuar në shërbimin publik, nga ky numër vetëm 113 prej tyre rezultojnë të jenë pjesëtarë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptianë dhe atë të punësuar vetëm në 10 prej këtyre institucioneve. Disa faktorë për gjendje jo të mirë të punësimit janë: mungesa e zhvillimit ekonomik dhe gjendja e përgjithshme e papunësisë në vend; mbingarkesa në administratën e vendit; privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore, politizimi i punësimit, mungesa e profilizimit të kuadrove, me theks të veçantë tek grup moshat mbi 30 vjeç.<sup>21</sup>

Duke pasur parasysh mundësit e kufizuara të punësimit në sektorin publik, dhe trendin e përgjithshëm të zhvillimit të tregut të punës, sektori privat mbetet ofruesi më i madh punësimit për të gjithë qytetarët përfshirë edhe pjestarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, punësimi i të cilëve në sektorin privat bëhet më me vështirësi, për shkak të ndryshme duke përfshi hezitimin e bizneseve që t'i pranojnë në punë pjestarët e komuniteteve, hezitimi i pjestarëve të komuniteteve që të punësohen për shkak të pagës së ulët dhe pasigurisë në kohëzgjatje të punësimit dhe mungesa e kualifikimeve, shkathtësive të kërkuara në tregun e punës.

### Masat Afirmative të Punësimit

Në mënyrë që të ju mundësohet punësimi i pjestarëve të këtyre komuniteteve, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, në bashkëpunim me Agjencionin e Punësimit të Kosovës (APRK) kanë dizajnuar Masat Afirmative të Punësimit, përmes zbatimit të të cilave qoftë me fonde publike apo të donatorëve ndihmohet punësimi i pjestarëve të komuniteteve në tregun e punës. Në drejtim të punësimit të komuniteteve përmes këtyre masave janë arritur rezultate të vogla, andaj papunësia tek këto komunitete vazhdon të jetë në nivel të lartë, për të ndryshuar gjendjen është e nevojshme të punohet në: përmirësimin e kushteve të punës në sektorin privat, sigurimi i kontratave të punës, paisja me mjete pune për veprimtaritë që kanë rrezik të lartë; promovimi dhe stimulimi i rasteve të suksesshme të punësimit të komuniteteve, që do të ndikonte në luftimin e paragjykimit ndaj tyre; ngritja e kontrollit nga inspektorët e punës me qëllim të monitorimit të punëdhënësit dhe punëmarrësit; përkrahje dhe

<sup>20</sup> Kodi Penal nr. 06/L-074 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413>

<sup>21</sup>Dh. Prokshi. (KOSINT). Respektimi i kuotës së punësimit të pjesëtarëve të komuniteteverome, ashkali dhe egjiptiane në institucione publike” (2019)

[http://kosint2020.net/site/assets/files/1448/respektimi\\_i\\_kuotes\\_se\\_punesimit\\_te\\_pjesetareve\\_te\\_komuniteteve\\_rome\\_ashkali\\_dhe\\_egjiptiane\\_ne\\_institucione\\_publike-1.pdf](http://kosint2020.net/site/assets/files/1448/respektimi_i_kuotes_se_punesimit_te_pjesetareve_te_komuniteteve_rome_ashkali_dhe_egjiptiane_ne_institucione_publike-1.pdf)

promovim i bizneseve që janë në udhëheqje të komuniteteve me anë të programeve të ndryshme zhvillimore.

### Korniza ligjore:

Sektori i punësimit, në vecanti punësimi në institucione publike, rregullohet nga akte të ndryshme ligjore, ku më e rëndësishmja është Kushtetuta e Republikës së Kosovës që thekson në nenin 61 që komunitetet dhe pjesëtarët e tyre do të kenë të drejtë për përfaqësim të barabartë në punësim në organet publike dhe ndërmarrjet publike në të gjitha nivelet, përfshirë këtu veçanërisht në shërbimin policor në zonat e banuara me komunitetin përkatës, duke respektuar në të njëjtën kohë rregullat që kanë të bëjnë me kompetencën dhe integritetin e qeverisjes së administratës publike.<sup>22</sup>

Ligji nr. 03/L-212 i punës në nenin 5 ndalon i të gjitha llojet e diskriminimit në punësim dhe profesion, lidhur me rekrutimin në punësim, trajnimin, promovimin e punësimit, kushtet e punësimit, masat disiplinore, ndërprerjen e kontratës së punës ose çështjeve të tjera nga marrëdhënia e punës të rregulluara me këtë ligj dhe me ligjet e tjera në fuqi. Gjithashtu neni 8 përshkruan që punëdhënësi në sektorin publik, është i obliguar që të shpall konkurs publik sa herë që pranon njëpunëmarrës dhe themelon një marrëdhënie të punës. Konkursi duhet të jetë i barabartë për të gjithë kandidatët e synuar, pa asnjë lloj diskriminimi.<sup>23</sup>

Ligji Nr. 03/L-149 për shërbimin civil, në nenin 11 Pranimi në Shërbimin Civil të Kosovës bëhet në pajtim me parimet e meritës, aftësisë profesionale, paanshmërisë, mundësive të barabarta, mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të barabartë, në bazë të konkursit publik dhe pas verifikimit të zotësisë së veprimit të kandidatëve. Në kuadër të shërbimit civil në institucionet e nivelit qendror minimum 10% e posteve duhet të rezervohen për personat të cilët u përkasin komuniteteve të cilët nuk janë shumicë në Kosovë dhe që përmbushin kriteret specifike të punësimit. Në nivelin komunal për anëtarët e kualifikuar të komuniteteve që nuk janë shumicë në komunë, do të jetë i rezervuar numri i vendeve të punës në pajtim me përfaqësimin procentual të komuniteteve të komunës së dhënë.<sup>24</sup>

Strategjia Sektoriale të MPMS 2018 –2022 përshkruan gjendjen ku qytetëret e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian janë pak të përfshirë në tregun e punës dhe masa aktive të tregut të punës. Për këtë arsye Objektivi specifik 1.5 parasheh të përmirësohet niveli i punësimit të pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.<sup>25</sup>

Strategjia për përfshirjen e komuniteteve Rom dhe Ashkali 2017-2021 përshkruan gjendjen e punësimit të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Punësimi është fusha 2, ku ka dhe rezultate specifike të cilat duhet të arrihen përmes aktiviteteve të caktuara deri në vitin 2021 duke përfshi përmirësimin e niveli i punësimit të pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkalinë institucione publike dhe ndërmarrje publike dhe pjesëmarrja në MATP.<sup>26</sup>

<sup>22</sup>Kushtetuta e Republikës së Kosovës <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>

<sup>23</sup>Ligji nr. 03/L-212 i punës <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2735>

<sup>24</sup>Ligji Nr. 03/L-149 për shërbimin civil <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2679>

<sup>25</sup>Strategjia Sektoriale të MPMS 2018 –2022 <https://mpms.rks-gov.net/wpdm-package/strategjia-sektoriale-2018-2022/>

<sup>26</sup>Strategjia për përfshirjen e komuniteteve Rom dhe Ashkali 2017-2021 <https://www.rcc.int/romintegration2020/download/docs/ALB->

Politika e Punësimit APRK 2019 – 2021 që ndërlidhet edhe me objektivat dhe rezultatet e dy strategjive më sipër, në Objektiven Strategjike 4.1.5 e specifikon që deri në vitin 2021 kërkohet që përqindja e përfituesve të MATP që i përkasin këtyre komuniteteve të rritet nga 6% deri në 10% dhe shkalla e punësimit të arrij 17%.<sup>27</sup>

#### Mekanizmat/institucionet përgjegjëse:

Institucionet kryesore që duhet të rregullojnë të drejtën e punës dhe masave afirmative për punësim janë, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Agjencioni i Punësimit të Kosovës, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Komunitat, dhe Zyrrat Rajonale të Punësimit.

#### Dispozitat ndëshkimore:

Sipas Ligjit nr. 03/L-212 të punës neni 92 parashihen gjoba për persona fizik ose persona juridik që nuk i përfillin dispozitat e këtij ligji, në procedurë ligjore, do të dënohen me të holla pre 100 deri në 10.000 Euro. Për më tepër, kur shkelja është bërë kundër të punësuarit nën moshën 18 vjeç, punëdhënësi apo personit tjetër përgjegjës, do të gjobitet me gjobë në lartësinë e dyfishit të përcaktuar më lartë. Cilido person që bën diskriminim, kundër personit i cili kërkon punë apo kundër të punësuarit, do të gjobitet në lartësinë e trefishit të përcaktuar më lartë. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, ka nxjerr UA nr. 07/2012 për përcaktimin e gjobave dhe shumave konkrete për shkelje dispozitave të ligjit të punës. Ky UA është shumë specifik dhe i përfshinë të punësuarit dhe punëdhënësit në sektor publik dhe privat.<sup>28</sup>

Në Kodin Penal nr. 06/L-074 parashihen masa ndëshkuese kundër të drejtave në marrëdhënie pune, në nenin 218 si kushdo që me vetëdije nuk e zbaton ligjin apo kontratën kolektive për punësimin apo ndërprerjen e marrëdhënies së punës; pagat apo të ardhurat e tjera; kohëzgjatjen e orarit të punës; punën jashtë orarit apo punën me ndërime; pushimin apo mungesën nga puna; ose mbrojtjen e grave, fëmijëve apo personave me aftësi të kufizuara dhe kësisoj punëtorit ia mohon apo ia kufizon të drejtat që i takojnë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit. Për më tepër neni 219 thekson se kushdo që ia mohon apo kufizon personave tjerë të drejtën në punësim në kushte të njëjta, ashtu siç është përcaktuar me ligj, dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy (2) vjet. Kushdo që nuk vepron në pajtim me legjislacionin mbi të drejtat e personave të papunësuar dhe me këtë ia mohon apo ia kufizon të drejtat që i takojnë atyre, dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy (2) vjet.<sup>29</sup>

## BANIMI

Banimit i qëndrueshëm është e drejte themelore e njeriut dhe ndikon drejtpërdrejt në rrjedhën e zhvillimit të përgjithshëm të shoqërisë si dhe është një komponentë e rëndësishme e zhvillimit socio-ekonomik, gjegjësisht të standardit jetësorë. Për pjestarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian ndër problemet dhe sfidat më të mëdha me cilat ballafaqohen vazhdon të jetë çështja e banimit, pronës,

[STRATEGJIA%20P%C3%8BR%20P%C3%8BRFSHIRJEN%20E%20KOMUNITETEVE%20ROM%20DHE%20ASHKALI%20N%C3%8B%20SHOQ%C3%8BRIN%C3%8B%20KOSOVARE%202017-2021.pdf/a8e1293c6955519e788ae28d84fb11a4.pdf](https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=40531)

<sup>27</sup>Politika e Punësimit APRK 2019 – 2021 <https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=40531>

<sup>28</sup>UA nr. 07/2012(MPMS) <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2735>

<sup>29</sup> Kodi Penal nr. 06/L-074 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413>

dokumentacionit dhe infrastrukturës në vendbanimet ku banojnë këta pjestarë pothuajse në secilën komunë.<sup>30</sup> Investimet kapitale në ndërtimin dhe rinovimin e shtëpive të pjestarëve të komuniteteve në të gjitha komunat bëhen kryesisht në bashkëpunim me donatorët ndërkombëtarë dhe vendorë, në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministrinë për Komunitete dhe Kthim, Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe me të gjithë pjesëtarët tjerë që ndihmojnë në procesin e sigurimit të strehimit.

### Korniza ligjore:

Ligji Nr. 03/L-164 për financimin e programeve të veçanta të banimit e ka për qëllim krijimin e kushteve për banim të qëndrueshëm për familjet ose individët të cilët nuk janë në gjendje ekonomike t'i përballojnë ofertat e tregut të lirë të banesave si dhe caktimi i mënyrës së sigurimit dhe shfrytëzimit të mjeteve financiare për zhvillimin e programeve të veçanta të banimit. Në ligj gjithashtu përshkruhen të drejtat dhe obligimet që të gjithë përfituesit e programeve të veçanta të banimit duhet të ju përmbahen.<sup>31</sup>

Udhëzimi Administrativ 22/2010 për procedurat e përfitimit nga programet e veçanta të banimit, përshkruan të gjitha hapat dhe institucionet që janë përfshira për të pranuar kërkesa për banim, krijimin e komisionit për përzgjedhje të familjeve dhe përzgjedhja e familjeve përfituese.<sup>32</sup>

Strategjia për përfshirjen e komuniteteve Rom dhe Ashkali 2017-2021 përshkruan gjendjen e banimit të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Banimi është fusha 4, ku ka dhe rezultate specifike të cilat duhet të arrihen përmes aktiviteteve të caktuara deri në vitin 2021 duke përfshi sigurimin e banimit të qëndrueshëm për komunitetet Rom dhe Ashkali në përputhje me legjislacionin në fuqi, të identifikoj nevojat e pjesëtarëve të komuniteteve për banim adekuat dhe banim social, ndërgjegjësimi i pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali për pjesëmarrje aktive në zgjidhjen e problemeve të banimit.<sup>33</sup>

### Mekanizmat/institucionet përgjegjëse:

Institucionet përgjegjëse për zbatimin e kornizës ligjore për banim janë: Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria për Komunitete dhe Kthim, Ministria e Punëve të Brendshme/ Departamenti për Ri-integrimin e Personave të Riatdhesuar (DRPR), Komunitat; Zyra për Komunitete dhe Kthim dhe Drejtoria për Punë dhe Mirëqenie Sociale. Në diskutimin publik të organizuar nga KOSINT lidhur me çështjen e politikave të banimit për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë, është

---

<sup>30</sup> KOSINT (2019). Diskutim Publik lidhur me çështjen e politikave të banimit për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë <http://kosint2020.net/sq/lajme-dhe-ngjarje/diskutim-publik-lidhur-me-ceshtjen-e-politikave-te-banimit-per-komunitetet-rom-ashkali-dhe-egjiptian-ne-kosove/>

<sup>31</sup> Ligji Nr. 03/L-164 për financimin e programeve të veçanta të banimit <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2670>

<sup>32</sup> Udhëzimi Administrativ 22/2010 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=7948>

<sup>33</sup> Strategjia për përfshirjen e komuniteteve Rom dhe Ashkali 2017-2021 <https://www.rcc.int/romaintegration2020/download/docs/ALB-STRATEGJIA%20P%C3%8BR%20P%C3%8BRFSHIRJEN%20E%20KOMUNITETEVE%20ROM%20DHE%20ASHKALI%20N%C3%8B%20SHOQ%C3%8BRIN%C3%8B%20KOSOVARE%202017-2021.pdf/a8e1293c6955519e788ae28d84fb11a4.pdf>

diskutuar që duhet të ketë më shumë koordinim mes këtyre institucioneve dhe të punohet në funksionalizimin e një databaze ndër-qeveritare, e cila ekziston, ku do të regjistroheshin të gjitha rastet që kanë nevojë për banim, të gjitha rastet ku kanë ndërtuar shtëpi/ banesa në secilën komunë. Kjo databazë do të ndihmojë në identifikimin e rasteve, zvogëlimin e manipulimeve, nuk do të lëjonte duplikimin e kërkesave, dhe bazuar në kriteret që do të plotësohen identifikimin e rasteve prioritare. Databaza do të plotësohet nga komunitetet dhe ministritë që mirren me këtë çështje.<sup>34</sup>

### Dispozitat ndëshkimore:

Ligji Nr. 03/L-164 për financimin e programeve të veçanta të banimit, neni 29 i përshkruan dispozitat ndëshkimore në raste të ndryshme. Kur shkeljet nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe shqiptohen dënime me gjobë: kur qiramarrësi ka bërë deklaram të rrejshëm për të ardhurat, qiramarrësi detyrohet të largohet nga banesa me qira dhe të kthejë shumën e përfituar nga programet e veçanta për banim. Kur qiramarrësi ka përfituar një banesë tjetër dhe nuk ka njoftuar organin kompetent komunal, qiramarrësi gjobitet me të holla në shumë prej 200 deri në 400 Euro. Kur qiramarrësi ia lëshon banesën me qira palës së tretë, qiramarrësi gjobitet me të holla në shumë prej 400 deri në 600 Euro. Për më tepër, falsifikimi i bonusit të banimit dënohet sipas Kodit Penal në fuqi me nenin 390 që ka të bëjë me falsifikim e dokumenteve dhe dënohet me gjobë dhe burgim prej prej 1 deri 8 vjet.<sup>35</sup> Shqiptimi i kundërvajtjeve bëhet nga organi kompetent komunal. Kundër vendimit të organit kompetent komunal mund të bëhet ankesë brenda 30 ditësh MMPH-së, përmes organeve komunale. Kundër vendimit më lartë, pala e pakënaqur mund të iniciojë kontest administrativ me padi në Gjykatën Kompetente.<sup>36</sup>

## MIRËQENIA SOCIALE

### Martestat ilegale (të hershme) nën moshën 18 vjeçare

Në Ligjin për martesën përcaktohet që me pëlqim të prindit ose kujdestarit ipet e drejta, lejohet një martesë në mbikëqyrje të shtetit. Një mundësi e tillë ligjore në Kosovë është keqpërdorur shumë dhe numri i martesave nën moshën 16 -vjeçare, brenda vitit arrin të jetë rreth 80 martesa.<sup>37</sup> Pasojat e martesave të hershme janë të shumta dhe të ndryshme. Sipas Fondit të Kombeve të Bashkuara për Fëmijët, UNICEF, një vajzë nën 15 vjet, është pesë herë më shumë në rrezik të vdesë gjatë shtatzënisë apo lindjes, se sa një grua në të 20-at. Kur një nënë është nën 18 vjet, shansi që foshnja e saj të vdesë gjatë vitit të parë është 60 për qind më e lartë sesa nëse foshnja lind nga një nënë mbi 19 vjeçe. Martestat e hershme janë më të shprehura tek komunitetet rom, ashkali e egjiptian, ku ndër më të

<sup>34</sup> KOSINT (2019). Diskutim Publik lidhur me çështjen e politikave të banimit për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë <http://kosint2020.net/sq/lajme-dhe-ngjarje/diskutim-publik-lidhur-me-ceshtjen-e-politikave-te-banimit-per-komunitetet-rom-ashkali-dhe-egjiptian-ne-kosove/>

<sup>35</sup> Kodi Penal nr. 06/L-074 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413>

<sup>36</sup> Ligji Nr. 03/L-164 për financimin e programeve të veçanta të banimit <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2670>

<sup>37</sup> Kallxo.com (2019). Rreth 80 martesa në vit të personave nën moshën 16-vjeçare. <https://kallxo.com/lajm/rreth-80-martesa-ne-vit-te-personave-nen-moshen-16-vjecare/>

prekurat nga pasojat janë vajzat duke sjellë shëndetin në rrezikshmëri të lartë, lindje të fëmijëve në moshë të re, braktisje të shkollimit dhe pamundësi që ndonjëherë të punësohen.

Gjithashtu, një hulumtim nga The Ideas Partnership gjatë vitit 2017 në Fushë Kosovë në lidhje me martesat e hershme, shihet se 53.57 % e respondentëve të intervistuar janë martuar nën moshën 18 vjeçare. Kjo dukuri ërveq rreziqeve më sipër, gjithashtu ndikon në numrin më të ulët të atyre që regjistrohen në arsimin e mesëm dhe atë universitar, dhe numë më të madh të braktisjes së shkollimit.<sup>38</sup>

#### Korniza ligjore:

Ligji nr. 2004/32 për familjen, është ligj i cili sipas nenit 1 regullon fejesën, martesën, marrëdhëniet ndërmjet prindërve dhe fëmijëve, adoptimin (birësim), kujdestarinë, mbrojtjen e fëmijëve pa përkujdesje prindërore, marrëdhëniet pasurore në familje dhe procedurat e posaçme të gjykatës përkitazi me kontestet lidhur me marrëdhëniet familjare. Për më tepër, neni 16, përshkruan kushtet e martesës ku personi i cili nuk ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjeçare nuk mund të lidhë martesë.<sup>39</sup>

#### Mekanizmat/institucionet përgjegjëse:

Institucionet përgjegjës për martesë jo ligjore, janë prindi, prindi adoptues, kujdestari apo ndonjë person tjetër që ushtron autoritet prindëror, policia, prokuroria, gjykata, organi i kujdestarisë, avokati i popullit dhe rrjeti i grave të Kosovës.

#### Dispozitat ndëshkimore:

Në Kodin Penal nr. 06/L-074 neni 238 përshkruan që personi i autorizuar zyrtar para të cilit lidhet martesa, i cili në keqpërdorim të pozitës apo autorizimeve të tij lejon lidhjen e martesës, ndonëse është në dijeni për pengesat ligjore të cilat e ndalojnë martesën, dënohet me burgim prej 3 muaj deri në 3 vjet. Neni 239 përshkruan që kushdo që e detyron personin tjetër të lidh martesë ose lidh martesë me personin për të cilin e di se është detyruar të hyj në martesë, dënohet me burgim prej 1 deri në 8 vjet. Kur vepra penale nga fjalja paraprake kryhet kundër fëmijës, kryesi dënohet me burgim prej 2 deri në 10 vjet. Kur martesa e detyruar kryhet nga prindi, në mes të moshës 16 dhe 18 vjet, kryesi dënohet me burgim prej 3 deri në 10 vjet. Kurrse për personat në mes të moshës 14 dhe 16 vjet, kryesi dënohet me burgim prej 5 deri në 10 vjet. Për më tepër për personat nën moshën 14 vjet, kryesi dënohet me burgim së paku 15 vjet.

Neni 240, përshkruan që personi madhor i cili bashkëjeton në një bashkësi jashtëmartesore me personin në mes të moshës 14 dhe 16 vjet, dënohet me burgim prej 5 deri në 20 vjet. Prindi, që i lejon ose e shtyn personin në mes të moshës 14 dhe 16 vjet që të bashkëjetojë në një bashkësi jashtëmartesore me personin tjetër, dënohet me burgim prej 5 deri në 20 vjet. Kur bashkësia jashtëmartesore ndodhë ndaj personit nën 14 vjet, kryesi dënohet me së paku 10 vjet burgim.<sup>40</sup>

#### Kërkim lëmosha

---

<sup>38</sup> TIP (2017). Fenomeni i Martesave të Hershme në Komunitetet Romë, Ashkali dhe Egjiptian në Komunën e Fushë Kosovës [http://theideaspartnership.org/wp/?page\\_id=701](http://theideaspartnership.org/wp/?page_id=701)

<sup>39</sup> Ligji nr. 2004/32 për familjen <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2410>

<sup>40</sup> Kodi Penal nr. 06/L-074 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413>

Problemi për kërkim lëmoshe është mjaft i madh dhe i dukshëm në të gjitha rrugët e Kosovës. Për shkak të varfërisë ekstreme ku fëmijët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, janë më të rrezikuarit. Kur fëmijët janë në rrugë për kërkim lëmoshe, atyre ju shkelen shumë të drejta duke ju rrezikuar jetën dhe mos vijimi i shkollës. Nga një reportazh i Kohavision të dhënat e Policisë së Kosovës tregojnë në 2016 ishin identifikuar 465 persona, kurse në 2018 janë identifikuar 577 persona.<sup>41</sup>

Organizata për mbrotjen e të drejtave të fëmijëve “Terre des hojmes” operon me ekipe mobile në terren, për të cilat cakton oraret, në orët e vona të natës në mbështetje edhe të Policisë së Kosovës . Në momentin e identifikimit bëhet referimi në institucione përkatëse. Mirëqenia e fëmijës është më rëndësishme por ne fuqizojmë edhe familjen. Komuna e Prishtinës, në bashkëpunim me Tdh, kanë hapur “Qendrën e qëndrimit ditor për fëmijë në situatë rruge”, me qëllim që të kontribuojë në mbrotjen dhe mirëqenien e fëmijëve duke zvogëluar kohën që ata kalojnë në rrugë, duke minimizuar rreziqet e mundshme që u kanosen atyre dhe të ofrojë një ambient të ngrohtë ku këta fëmijë do të ndihen të sigurt.<sup>42</sup>

### Korniza ligjore:

Ligji nr.06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, ka për qëllim mbrotjen e fëmijëve në cdo hapsirë dhe institucion që ata janë pjesë. Neni 8, më specifikisht përshkruan që asnjë fëmijë nuk duhet të diskriminohet, dhe se cdo fëmijë ka të drejtë në të njëjtat të drejta të njohura me legjislacionin në fuqi dhe Konventën, t’i garantohen ato pa asnjë lloj dallimi, pavarësisht nga raca, ngjyra, gjinia, gjuha, feja, opinioni politik ose çdo opinion tjetër, nga origjina kombëtare, etnike ose shoqërore, pasuria, paaftësia, prejardhja familjare apo çdo gjendje tjetër e fëmijës ose prindërve të tij, apo përfaqësuesve të tij ligjorë. Sipas nenit 26, është detyrë e secilit qytetarë të raportoj raste nëse janë të informuar që ndaj fëmijës është ushtruar çdo formë e dhunës fizike ose mendore keqtrajtimi, braktisja, abuzimi, neglizhimi dhe shfrytëzimi është i obliguar që të raportojë rastin, me shkrim ose gojarisht në polici ose në Qendrën përkatëse për punës sociale. Neni 37, siq është përshkruar edhe te kapitulli i Arsimit shpjegon detajisht se si ndalohet privimi i fëmijës nga e drejta për edukim dhe arsimim Neni 50, përshkruan moshën minimale për punësim, ku asnjë punëdhënës nuk mund të punësojë dhe lidhë kontratë pune me ndonjë fëmijë nën moshën 15 vjeç . Neni 51 përshkruan punën e cila është e ndaluar për fëmijët, ndalohet punësimi i fëmijës në aktivitete që dëmtojnë sigurinë, shëndetin, moralin dhe zhvillimin psikofizik të fëmijës, si rezultat i mungesës së përvojës dhe njohurive për kryerjen e punëve dhe detyrave të punës.<sup>43</sup>

### Mekanizmat/institucionet përgjegjëse:

Sipas Ligjit nr.06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, neni 9 përshkruan struktura dhe mekanizmat institucionalë për të drejtat e fëmijës në nivel qendror dhe lokal. Ato qendrore janë: avokatit i popullit, ministritë përkatëse, komiteti ndërministror për të drejtat e fëmijës, këshilli për të drejtat e fëmijës. Institucionet lokale janë: komunat, qendra për punë sociale, dhe ekipi për të drejtat e fëmijës.<sup>44</sup>

<sup>41</sup> KohaVision (2018). Eksploatimi i lypsarëve. <https://www.koha.net/video/157710/eksploatimi-i-lypsareve/>

<sup>42</sup> KohaVision (2019). Hapet Qendra e qëndrimit ditor për fëmijët në situatë rruge në Prishtinë <https://www.koha.net/metro/192297/hapet-qendra-e-qendrimit-ditor-per-femijet-ne-situatë-rruge-ne-prishtine/>

<sup>43</sup> Ligji nr.06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=20844>

<sup>44</sup> Ligji nr.06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=20844>

Policia e Kosovës gjithashtu luan rol të rëndësishëm në ndalimin e kërkim lëmshës, duke i identifikuar rastet në terren. Policia në bashkëpunim me shërbimet sociale dhe gjykatat ndërmerr aktivitete për largimin e tyre nga rruga

### Dispozitat ndëshkimore:

Në Kodin Penal nr. 06/L-074 neni 163 përshkruan që kushdo që në mban në skllavëri, kushtet e ngjashme me skllavërinë dhe punë të dënohet me gjobë dhe me burgim prej 2 deri në 10. Nëse situata paraprake kryhet kundër personit me të cilin kryesi është në marrëdhënie familjare, kryesi dënohet me burgim prej 3 deri në 10 vjet. Kur e njëjta kryhet ndaj fëmijës, kryesi dënohet me burgim prej 3 deri në 15 vjet.

Neni 243 thekson kur prindi, prindi adoptues, kujdestari apo personi tjetër që ushtron autoritet prindëror mbi fëmijën keqtrajton apo braktisë fëmijën në mënyra të ndryshme dënohet me burgim prej 3 muaj deri në 8 vjet.

Sipas nenit 247 edhe mos raportimi i abuzimit të fëmijëve nga kushdo, dënohet me gjobë ose me burgim deri 3 vjet. Nëse mos raportimi i abuzimit rezulton me vdekjen e fëmijës apo me dëmtim të rëndë të shëndetit të tij, kryesi dënohet me burgim prej 1 deri në tetë 8 vjet.

## Përfundim

Nga analiza e gjendjes faktike të respektimit të të drejtave të pjestarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë në fushat e arsimit, punësimit, banimit dhe mirëqenies sociale dhe krahasimit në periudha të ndryshme respektimit të të drejtave të komuniteteve në fjalë vijmë në përfundim se pozita e komuniteteve në shoqërinë kosovare është përmirësuar.

Kosova si shtet i ri nga analiza e ofruar në këndvështrimin juridik për fushat e arsimit, punësimit, banimit dhe mirëqenies sociale ka arritur që të zhvilloj kornizë të cilësisë së lartë juridike, ka krijuar mekanizma dhe ka hartuar strategji në përputhje me standardet evropiane për sigurimin e të drejtave të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Pëkundër këtij fakti, këto komunitete vazhdojnë të jenë më të cenurat në vend, kjo si rrjedhojë e mos zbatimit të ligjeve dhe mos funksionimit të mekanizmave të thirrur për zbatimin e ligjit.

Respektimi i të drejtave të pjestarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian do të pëson ngritje dhe përmirësim optimal në rast të komunikimit dhe bashkëveprimit më të mirë të institucioneve dhe mekanizmave lokal dhe qendror, dhe atyre ndërsektorial.